VENDIM
Nr. 9, datë 11.1.2016

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË PËRFITIMIT TË VESHMBATHJEVE CIVILE PËR PUNONJËSIT E POLICISË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(ndryshuar me vendimin nr. 807, datë 12.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 13/2015, "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake trajtohet me veshmbathje civile në vlerë leku, një herë në vit, *në masën e një page mujore.*

2. Kriteret që duhet të plotësojë punonjësi për përfitimin sipas pikës 1 janë:

a) Të ketë jo më pak se një vit pune në Policinë Ushtarake;

b) Të jetë ushtarak aktiv ose civil i emëruar në Policinë Ushtarake.

3. Trajtimi financiar jepet në muajin e parë të plotësimit të një viti nga trajtimi i mëparshëm.

4. Referencë për trajtimin financiar merret paga që përfituesi ka në momentin e lindjes të së drejtës së përfitimit.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama